



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr.46/2018  
Prishtinë, më 30.10.2018, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari- Lila, Memli Krasniqi, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

**Munguan:** Glauk Konjufca dhe Liburn Aliu, anëtarë.

**I ftuar:** z. Rasim Demiri, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZHR).

**Pjesëmarrës tjerë:** Fatos Qerimi, Eldis Abazi, Lidon Pajaziti – MZHR; Liridon Gashi – SEEF; Vatra Qehaja – LVV; Diellza Luzha – KDI dhe Arbisa Shefkriu – Kallxo.com.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesoi:** Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.10.2018;
3. Raportim i ministrit të Zhvillimit Rajonal, z. Rasim Demiri, lidhur me realizimin e planit të punës së këtij viti dhe planifikimet për vitin e ardhshëm, me theks të veçantë për subvencionet;
4. Të ndryshme.

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.10.2018**

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 23.10.2018, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Raportim i ministrit të Zhvillimit Rajonal, z. Rasim Demiri, lidhur me realizimin e planit të punës së këtij viti dhe planifikimet për vitin e ardhshëm, me theks të veçantë për subvencionet**

**Kryetarja** theksoi se me kërkesën e deputetit Veton Berisha, mbështetur edhe nga deputetë tjerë, është ftuar z. Rasim Demiri, ministër i Zhvillimit Rajonal, të raportojë lidhur me realizimin e planit të punës së këtij viti dhe planifikimet për vitin e ardhshëm, me theks të veçantë për subvencionet, dhe ia kaloi fjalën ministrit.

**Rasim Demiri, ministër i Zhvillimit Rajonal**, theksoi se do të raportojë për zhvillimet e aktiviteteve të ministrisë, në përputhje me mandatin ligjor dhe bazuar në planin e punës. Ai sqaroi se ministria nuk ka subvencione, por ka grante. Ai tha se në pika të shkurta do të paraqes konceptin në cilën mënyrë ne kemi vepruar dhe në cilën mënyrë i kemi shpërndarë grantet. Sa i përket Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, ju jeni dëshmitarë se është ministri e re, dhe nga fillimi i punës ne kemi pasur vështirësi gjatë punës tonë. Por në fund ne kemi arritur sukses. Ne kemi hartuar Koncept- Dokumentin për Zhvillim Rajonal, për të cilin janë kryer konsultimet, janë marrë pëlqimet nga ministrinë e linjës dhe është miratuar në Qeveri më 22 gusht 2018. Pastaj kemi hartuar Strategjinë për zhvillim rajonal dhe është themeluar Grupi punues për përgatitjen e profileve rajonale. MZHR ka realizuar takime me UNDP, Komisionin Evropian, GIZ, UN-HABITAT me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta. Ne kemi hartuar programin për zhvillim rajonal, kemi zbatuar programin tonë dhe buxhetin tonë në implementimin e 20 projekteve infrastrukturore në vlerë prej 2 milionë euro, dhe me participimin e komunave kemi pasur një fond prej 4 milionë e 600 mijë euro, dhe kanë qenë të investuara në mjedise të ndryshme dhe ne kemi arritur që në të gjitha rajonet të investojmë. Sa i përket granteve, programi i ministrisë ka qenë që ne të jemi të përfaqësuar në 5 rajone ekonomike dhe në këtë mënyrë kemi dashur që të krijojmë dhe të kemi një balancë, kur janë në pyetje shpërndarjet e projekteve. I tërë procesi ka qenë transparent që nga fillimi i aplikimit, dhe në këtë na ka ndihmuar edhe Agjencia për Zhvillim Rajonal, dhe aplikimi ka qenë përmes atyre Agjencive. Nga 1 milion e 400 mijë euro kanë përfituar grante 128 biznese. Me këto grante ne kemi arritur të krijojmë mundësinë për 608 vende të reja pune. Ne jemi duke bërë përpjekje të bashkëpunojmë me shtetet fqinje dhe kemi realizuar vizita në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi për të parë përvojat e shteteve fqinje në zhvillimin rajonal. Sa i përket granteve mendojmë që buxheti të jetë 2.5 milionë euro për vitin e ardhshëm. Pas miratimit të buxhetit, në vitin 2019, sipas procedurave të rregullta do të bëjmë ftesë publike për dhënien e granteve.

**Veton Berisha** falënderoi ministrin për prezantimin e punës së ministrisë dhe ngriti disa çështje rreth punës së ministrisë. Duke iu drejtuar ministrit ai theksoi se në raportimin e juaj të kaluar, keni parashtruar para këtij komisioni edhe planin e juaj për punën e ministrisë. Nga atëherë

kanë kaluar më shumë se 9 muaj, andaj, të gjithë jemi të interesuar të dëgjojmë se sa keni arritur të realizoni planin. Sa i përket projekteve të investimeve kapitale, sa projekte të investimeve kapitale janë realizuar? Në raportin financiar të ministrisë për janar-qershor 2018, përcaktohet se 1 milion e 500 mijë euro kanë qenë të dedikuara për subvencione dhe transfere. Si janë shfrytëzuar këto fonde, nga qershori deri më tani? Sa nga këto fonde janë dedikuar për komunitetet, dhe nga këto veçanërisht sa janë të dedikuara për Komunitetin Egjiptian? Cili është procesi i analizës dhe vendim-marrjes që keni praktikuar, për alokimin e fondeve, në komunat përkatëse, dhe projektet përkatëse? A janë krijuar mekanizma monitorimi, dhe si po funksionojnë ato për t'u siguruar që fondet e ndara nga Ministria shfrytëzohen në përputhje me qëllimin për të cilin janë dedikuar? Sa janë marrë parasysh nevojat e komuniteteve jo-shumicë në planifikimet buxhetore të ministrisë? A ka pasur zbatim të përqindjeve të caktuara të granteve për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë? Sa i përket vendeve të punës, në raportimin e fundit keni përmendur shumë prej 1 milion e 500 mijë euro, që do të krijonte 500 deri në 600 vende të reja pune. Si ka shkuar realizimi i këtij projekti? Sa janë përfshirë komunitetet jo-shumicë në këtë projekt? Sa është numri i të punësuarve?

**Rasim Demiri, ministër,** duke u përgjigjur në pyetjet e deputetit Berisha, theksoi se është e qartë që Ministria për Kthim dhe Komunitete është ministri e cila merret me çështjet e komuniteteve, ndërsa Ministria e Zhvillimit Rajonal nuk ka në program diçka të veçantë të paraparë vetëm për komunitetet pakicë, përveç asaj që është me ligj që 10% e të punësuarve të jetë nga komuniteti pakicë, dhe në këtë e kemi respektuar. Në procesin e dhënies së granteve shikohet vetëm a i plotëson kushtet e kërkuara dhe nuk shikohet se cilit komunitet i takon, dhe as në formularët e aplikimit askund nuk kërkohet deklarami i komunitetit. Unë kam informatë se janë të përfaqësuara të gjitha komunitetet në këto grante. Në dhënien e granteve nuk ka rregulla që përcaktojnë se kjo apo ajo përqindje e granteve i takon komunitetit të caktuar. Te shifra 608 vende të reja të punës kemi ardhur pasi që përfituesit e granteve kanë qenë të obliguar që punëtorët t'i kenë të regjistruar në administratën tatimore.

**Fatos Qerimi, sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë,** sqaroi se fondet janë alokuar në qershor. Procesi i dhënies së granteve është përfunduar dhe tani jemi në fazën e implementimit të projekteve. Deri në fund të vitit nuk do të kemi mundësi të dihet numri i saktë i vendeve të reja të punës, por pritjet të jetë rreth 600. Do të bëhet një analizë e implementimit dhe do të shihet edhe ndikimi i granteve në numrin e të punësuarve. Monitorimi do të zgjatë dy vjet nga përfundimi i projektit. Projekte kapitale janë 2 milionë euro në dispozicion, për 20 projekte në 17 apo 18 komuna.

**Hykmete Bajrami** pyeti se kush kanë qenë anëtarë të Komisionit për dhënien e granteve? A kanë qenë vetëm nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, apo edhe nga shoqëria civile, odat ekonomike, etj.? Si keni vepruar me ankesat? Kush ka me qenë në Komisionin monitorues? Është mirë të shihet se këto grante a po ndikojnë në zhvillimin ekonomik. A ka mundësi që të njëjtat ndërmarrje të aplikojnë për grante edhe në ministri të tjera? A ka mekanizma koordinues me ministritë e tjera në dhënien e granteve?

**Rasim Demiri, ministër,** sqaroi se komisioni për vlerësimin e këtyre projekteve ka qenë i përbërë nga personat apo nga shërbyesit civil nga Ministria e Zhvillimit Rajonal. Sugjerimin që të përfshihen edhe shoqëria civile në komisionet për vlerësimin e projekteve, për ne, si ministri,

do të ishte lehtësim në qoftë se në komision për vlerësimin e projekteve do të kishim edhe përfaqësuesit nga organizatat joqeveritare. Ne kemi pasur edhe listën rezervë të përfitueseve dhe ata që janë tërhequr janë zëvendësuar nga lista rezervë.

**Fatos Qerimi, sekretar,** sqaroi se ne kemi pasur dy komisione të vlerësimit të cilat i kemi pasur të parapara me udhëzim administrativ. Komisioni për vlerësim administrativ të projekteve dhe bizneseve të cilat kanë aplikuar, dhe pas fazës së parë të komisionit administrativ e kemi pasur edhe komisionin përmbajtjesor mbi bazën e të cilëve na është afruar lista fillestare e përfitueseve. Mandej ka qenë edhe një ekip që ka dalë në terren për me i verifikuar aplikuesit dhe pas verifikimit në terren është shpallur lista përfundimtare e përfitueseve. Prej rreth 700 aplikuesve kanë qenë 30 ankesa, të cilat kanë qenë në fazën e komisionit administrativ të cilat i kemi trajtuar. Monitorimi mendohet të bëhet përmes zyrtarëve të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal. Aplikuesi në formularin e aplikimit nënshkruan se me të njëjtin projekt nuk ka aplikuar diku tjetër.

**Dardan Sejdiu,** theksoi se Qeveria ka 8 ministri që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik. Sa keni takime mes jush, a janë të rregullta dhe si koordinoheni me Ministrinë e tjera? Cila është përqindja e shpërndarjeve të granteve nëpër rajone? A është bërë shpërndarja e granteve mbi bazën e kritereve të vlerësimit dhe mbi bazën se ku ka nevojë më shumë të jepen grante që të arrihet një balancë mes rajoneve? Cila është vlera mesatare e granteve? A keni paraparë që për vitin tjetër të jeni më efikas në dhënien e granteve?

**Fatos Qerimi, sekretar,** sqaroi se bashkëpunim kemi me ministrinë e tjera dhe e kemi obligim bashkëpunimin sipas Rregullores së Qeverisë për fushat e përgjegjësisë së ministrive. Shpërndarja në rajone ka qenë përafërsisht e barabartë me rreth 250 mijë euro nëpër rajone. Të gjitha komunat kanë përfituar grante. Kanë qenë 1.4 milion euro për grante dhe kur pjesëtohet me numrin e përfitueseve del mesatarja e granteve. Ne do të hartojmë profilet ekonomike të rajoneve në mënyrë që të shohim cili është më i zhvilluar e cili më pak, që mandej të orientojmë grantet për të arritur një balancë mes rajoneve.

**Kryetarja** potencoi se e kuptuam nga ministri dhe nga sekretari se së pari merren parasysh kushtet dhe jo komunitetet. Gjithsesi me rëndësi janë kushtet e përfituesve të granteve dhe jo rajonet. Është shumë mirë që do të bëhet edhe profili i rajoneve që pastaj me vendosur një balancë të zhvillimit të rajoneve. Duhet të ndihmohen aplikuesit që vijnë ndoshta nga zona të pazhvilluara që t'i plotësojnë kushtet e kërkuara për grant.

**Memli Krasniqi,** pyeti pse janë 5 rajone, e jo 7 për shembull, mbi çfarë baze i keni ndarë këto rajone? Sa ka qenë granti minimal dhe granti maksimal? Në cilat fusha keni ndarë grante? Këto 608 vende të reja pune që po mendoni se po krijohen, sa janë të qëndrueshme, sepse kostoja për një vend pune sipas kësaj logjike është shumë e ultë dhe nëse është kështu ta marrim edhe si model për rritjen e vendeve të punës. E përgëzoj ministrin për këtë projekt.

**Rasim Demiri, ministër,** sqaroi se në Ministrinë e Pushtetit Lokal ka një zyrë për zhvillim rajonal dhe janë 5 rajone. Ne e kemi marrë prej tyre këtë model të ndarjes në 5 rajone. Grante ka pasur me 5 mijë, ka pasur me 20 mijë euro. Në procesin e dhënies së granteve janë marrë parasysh kur kanë qenë në pyetje gratë në projekte.

**Fatos Qerimi, sekretar,** sqaroi se këto rajone janë rajone ekonomike dhe nuk kanë të bëjnë asgjë me ndonjë organizim të ri administrativ apo territorial dhe kjo është përfshirë edhe në rregulloren e qeverisë për përgjegjësitë e ministrive. Kur ta hartojmë profilin e rajoneve ekonomike do të shohim nivelet e zhvillimit të rajoneve dhe mandej do të kemi një pasqyrë të qartë për orientimin e granteve.

**Muharrem Nitaj,** duke iu referuar pohimit se kanë qenë 30 ankesa, pyeti se sa prej atyre ankesave kanë rezultuar që komisionet vlerësuese nuk e kanë bërë punën siç duhet? A ka pasur ndonjë ankesë e bazuar dhe që është vendosur në favor të palës? A mund të na sqaroni rastin e pretendimit për aferë korruptive të ish-zëvendësministrit të kësaj ministrie?

**Adem Hoxha** mbështeti ato që u thanë nga deputetët e tjerë. Ai kërkoi që lista me emra të përfituesve të jetë publike që të mund ta shohim. Po ashtu, ai kërkoi që gjatë dhënies së granteve të mbështeten komunitetet pakicë.

**Rasim Demiri, ministër,** theksoi se ajo që ka ndodh me ish-zëvendësministrin e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal na vjen keq. Unë si ministër jam i kënaqur me punën e tij në ministri. Unë di lidhur me këtë rast aq sa është thënë në media. Ajo për çka akuzohet ish-zëvendësministri nuk ka të bëjë me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal. Listën me emra të përfituesve e kemi të publikuar në ueb-faqe të ministrisë.

**Fatos Qerimi, MZHR,** sqaroi se kanë qenë rreth 30 ankesa. Ankesat kanë pasur të bëjnë me vlerësimin administrativ dhe rreth 90% e tyre janë refuzuar.

**Veton Berisha,** falënderoi ministrin dhe sekretarin për sqarimet. Ai theksoi se vetë mandati i ministrisë është për balancim të zhvillimit rajonal. Është krijuar një lloj praktike që nga vjen ministri shkojnë më shumë edhe grantet dhe subvencionet, dhe kjo është shqetësuese. Deputeti Berisha pyeti se a keni paraparë fushata sensibilizimi për komunitetet? Ai shtoi se nuk kam informatë se dikush nga komuniteti egjiptian ka përfituar grant. Komisioni i vlerësimit a e ka obligim t'i ruajë informatat që mos të dalin para kohe në opinion, sepse po ka raste kur njerëz të ndryshëm shkojnë te persona potencialisht të mundshëm për aplikim dhe i premtojnë grante në këmbim të përfitimeve personale. Pres që në të ardhmen të mbështeten komunitetet me grante.

**Rasim Demiri, ministër,** përsëriti se Ministria e Zhvillimit Rajonal nuk lidhet me komunitetet pakicë. Ne duhet të kemi një model. Unë mendoj se të gjitha komunitetet duhet të jenë të përfaqësuara në përfitimin e granteve. Nëse dikush mendon se është keqpërdor diçka në procesin e dhënies së granteve nga persona të ndryshëm atëherë të denoncohet. Ne do të hartojmë një strategji për vitin 2019 lidhur me programin e granteve. Do të marrim shembuj nga ministritë e tjera se si i trajtojnë komunitetet pakicë gjatë dhënies së granteve.

**Kryetarja** falënderoi ministrin dhe bashkëpunëtorët e tij për prezantimin e punës së ministrisë si dhe e përgëzoi ministrin për programin e granteve që pritet të mundësojë rreth 600 vende të reja pune. Ajo shtoi se ne të gjithë jemi të thirrur të punojmë në të mirë të mirëqenies së të gjithë qytetarëve të Kosovës.

*Pas debatit, komisioni nxori këtë:*

### *Përfundim*

*Ministria e Zhvillimit Rajonal në kuadër të përgjegjësisve të veta të angazhohet në zhvillimin e politikave të qëndrueshme ekonomike për një zhvillim rajonal të balancuar, ku do ta këtë mbështetjen e komisionit.*

#### **4. Të ndryshme Çështjet vijuese.**

**Kryetarja**, njoftoi se ka marrë një letër nga kryetari i bordit të Trepçës për mos funksionimin e Trepçës. Ai në këtë letër i cek një varg pengesash të cilat janë të mundshme të evitohen. Po ashtu kryetarja theksoi se ka marrë një letër nga një investitorë shumë i rëndësishëm në komunën e Dragashit, i cili pret zbatimin e vendimit të KEDS-it për me funksionalizuar projektin e tij milionësh. Ne, si komision, përveç detyrave të rregullta jemi të obliguar me i vizituar edhe bizneset të cilat investojnë në Kosovë dhe me i mbështetë. Njoftoi se ka pas takim edhe me Klubin e Prodhuesve të Kosovës ku na njoftuan se ka filluar të zbatohet ligji për mbrojtjen e konsumatorit, dhe ky është një lajm i mirë.

**Duda Balje** sqaroi se ndërmarrja “Renelual Tahiri” ka ndërtuar një mini-hidrocentral atje në Komunën e Dragashit, në të cilën ka investuar rreth 8 milionë euro dhe ka punësuar 47 persona. Tash kjo ndërmarrje ka problem për kyçe në sistem të KEDS-it. Unë e kam vizituar këtë ndërmarrje dhe bashkë me përfaqësuesin e ndërmarrjes kemi shkuar në KEDS për takim. Takimi nuk ka dhënë asnjë rezultat. Kam kontaktuar institucionet si ZRRE dhe KOSTT. Ndërmarrja “Renelual tahiri” tash në këtë moment nuk ka mundësi me gjetur zgjidhje. Unë jam për me i thirre me ardhur këtu të sqarojnë ata që janë përgjegjës. Ndërmarrja është në mes të investimit dhe janë në një pozitë shumë të keqe.

**Kryetarja** theksoi se nuk e di se cili do të ishte roli i komisionit në këtë rast. Unë kam qenë në ZRRE për çështje të tjera dhe kam biseduar edhe për këtë rast dhe ata thonë se prej anës ZRRE-së është në rregull, e ka lejen, e ka lejen edhe të KEDS-it që e ka marrë në qershor. Mirëpo KEDS-i nuk është i gatshëm me i kyç në rrjet dhe nuk e di nëse është çështje për diskutim në komision.

*Komisioni do të bëjë vizita institucioneve dhe bizneseve në bazë të planit të punës dhe në bazë të kërkesave të palëve.*

**Mbledhja përfundoi në orën 13:00.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetarja e komisionit,**

-----  
**Sala BERISHA SHALA**